9 Numrin e telefonit të këshilltarit apo avokatit, ose numrin e telefonit të organizatës së tyre.

10 Datën e kontaktit tuaj të parë më këshilltarin apo avokatin

11 Lutemi të jepni hollësi të plota të ankesës suaj, përfshirë datat atje ku është e mundur (në rast se është e domosdoshme, mund të vazhdoni në një fletë shtesë)



Ne i shqyrtojmë të gjitha ankesat që na drejtohen. Megjithatë, në rast se në nuk jemi në gjendje t'u japim njerëzve emrin tuaj, apo emrin e personit në emër të të cilit ju ankoheni, kjo mund të ketë ndikim mbi çështjen tuaj.

Autorizoj OISC-në që, po të jetë e domosdoshme, t'u tregojë njerëzve emrin tim dhe/ose emrin e personit në emër të të cilit kam bërë ankesën. (Lutemi vini kryq në kuti).

☐

12 Firma

13 Data

14 Ku keni dëgjuar për OISC-në? (Bëhet për çështje të kontrollit të brendshëm)



shkëputeni këtu

Albanian

# Skema e Ankesave e Komisionerit të Shërbimeve për Imigrantët

## Formulari i ankesave

Zyra e Komisionerit të Shërbimeve për Imigrantët (OISC) bën të mundur që këshilltarët e çështjeve të imigracionit të jenë të pajisur me shprehi dhe njohuri për dhënien e këshillave për imigracionin dhe që ata të veprojnë në të mirë të personave që kërkojnë këshilla. Këtë ne e bëjmë duke mbajtur një listë të këshilltarëve të miratuar dhe duke kontrolluar që ata të japin gjithnjë këshilla të vlefshme. Ne po kështu merremi edhe me ankesat në lidhje me ndonjë këshilltar – edhe në rast se ai nuk është në listën tonë. Ne jemi organizatë e pavarur.

OISC
OFFICE OF THE IMMIGRATION SERVICES COMMISSIONER

## Për kë mund të ankoheni

Në rast se mendoni se këshilltari apo avokati juaj i imigracionit ju ka trajtuar keq ose ju ka dhënë këshilla pa vlerë, mund të ankoheni pranë OISC-së. Mund të ankoheni për cilindo këshilltar apo avokat – edhe në rast se ata i keni siguruar pa ndihmën e OISC-së. Ne synojmë të sigurojmë që të gjithë këshilltarët të japin këshilla të vlefshme, dhe të gjitha ankesat i trajtojmë me seriozitet.

## Për çfarë mund të ankoheni

Mund të ankoheni për çfarëdo problemi lidhur me imigracionin që është krijuar ndërmjet jush dhe këshilltarit apo avokatit të çështjeve të imigracionit, përfshirë:

- këshilla dhe/ose shërbim të pavlerë
- marrjen e udhëzimeve të papërshtatshme
- pretendimet e pabazuara për sukses
- pagesat e paarsyeshme dhe/ose kërkesat për pagesë për punë që nuk është bërë
- kërkesa që ju të bëni deklarata të falsifikuara ose të paqarta
- mospërmbushjen e afateve ose mosparaqitjen në gjyq.

Në rast se dëshironi, ne kemi mundësi të shfrytëzojmë përkthyesit për të siguruar hollësitë e ankesave tuaja.

## Çfarë bëjmë me ankesat tuaja

Ne e shqyrtojmë ankesën tuaj dhe vendosim se çfarë veprimi duhet ndërmarrë, në rast se është e domosdoshme. Në rast se këshilltari juaj shkel ligjin, ne mund ta pezullojmë nga puna. Në rast se ankesa juaj bëhet për një avokat, ankesën tuaj ne mund t'ia kalojmë organit ligjor të përshtatshëm.

## Për çfarë nuk mund t'ju ndihmojmë

- për përshpejtimin e kërkesës suaj për strehim
- për një ankesë e cila është duke u trajtuar nëpërmjet një veprimi ligjor
- për një ankesë kundër një personi që mban një funksion të Kurorës në kohën që ata veprojnë në atë kapacitet
- për një ankesë lidhur me një çështje që ka ndodhur më shumë se gjashtë muaj më parë (kjo është në dorën tonë)

## Si bëhet ankesa

Ankesën mund ta bëni duke mbushur formularin e ankesave dhe duke e postuar në adresën tonë në: Office of the Immigration Services Commissioner, Complaints Team, 5th Floor, 53 Tooley Street, London SE1 2QN.

Ne pastaj do t'ju njoftojmë se e kemi marrë ankesën dhe i shqyrtojmë të gjitha ankesat.



shkëputeni këtu

# Formulari i ankesave

OISC
OFFICE OF THE IMMIGRATION SERVICES COMMISSIONER

Në rast se dëshironi të ankoheni për një këshilltar apo avokat të çështjeve të imigracionit, lutemi plotësoni këtë formular dhe postojeni në adresën tonë në: Office of the Immigration Services Commissioner, Complaints Team, 5th Floor, 53 Tooley Street, London SE1 2QN.

Në rast se keni nevojë për ndihmë për të plotësuar formularin, lutemi telefononi linjën tonë të ndihmës në 0845 000 0046. Telefonata kushton sa telefonatat lokale.

Po qe se është e mundur, bashkë me formularin dërgoni edhe kopje të dokumentave përkatës.

1 Emri juaj i plotë

2 Adresa juaj

3 Numri i telefonit

4 Adresa e e-mailit

5 A jeni duke u ankuar në emër të një personi tjetër?

Po ☐ Jo ☐

**Në rast se jo, shkoni në pyetjen 6**

Në rast se po, lutemi të jepni:

a) emrin e personit në emër të të cilit ankoheni



b) adresën e personit në emër të të cilit ankoheni

c) numrin e telefonit të personit në emër të të cilit ankoheni

d) adresën e e-mailit të personit në emër të të cilit ankoheni

e) lidhjen tuaj me personin në emër të të cilit ankoheni

6 Emrin e këshilltarit apo avokatit për të cilin doni të ankoheni

7 Emrin e organizatës për të cilën punon këshilltari apo avokati (ku është e përshtatshme)

8 Adresën e këshilltarit apo avokatit, ose adresën e organizatës së tyre